



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës  
Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

NR.I PROTOKOLIT 613

NR I FAQEVE TË BASHKANGJITURA 04

DATA 22/12/2023 P.K. 27

PRISHTINË - KOSOVË

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists

## RREGULLORE

### PËR CAKTIMIN E PAGAVE DHE MËDITJEVE NË OFTK



Prishtinë, Dhjetor 2023

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.  
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1<sup>st</sup> Floor, RKS-10000.  
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail [info@oftk-ks.org](mailto:info@oftk-ks.org); web : [www.oftk-ks.org](http://www.oftk-ks.org)

Oda e  
Fizioterapeutëve  
të Kosovës





**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova**  
**Kosovo Chamber of Physiotherapists**

**KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TE KOSOVËS**, ne mbështetje te Nenit 19 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionisteve Shëndetësorë, nenit 20 paragrafi 13 të Statutit të Odës së Fizioterapeutëve te Kosovës në mbledhjen e mbajtur të datës 22.12.2023 miraton plotësim ndryshimin e:

**R R E G U L L O R E**

**PËR CAKTIMIN E PAGAVE DHE MËDITJEVE NË OFTK**

(Tekst i spastuar me plotësime dhe ndryshime sipas Vendimit të Kuvendit të OFTK-së nr.606, dt.22.12.2023)

**Pagat**

**Neni 1**

- 1.1. Koeficienti i pagës së Kryetarit është 10 (dhjetë).
  - 1.2. Koeficienti i pagave të Zv. Kryetarëve është  $\frac{1}{2}$  e pagës së Kryetarit të punësuar me gjysme norme,
  - 1.3. Koeficienti i pagës së Sekretarit të Odës është 6.0.
  - 1.4. Koeficienti i pagës së Zyrtarit për Buxhet dhe Financa është 5.5.
  - 1.5. Koeficienti i pagës së Zyrtarit Ligjor është 5.5.
  - 1.6. Koeficienti i pagës së Asistentes Ekzekutive është 5.0.
  - 1.7. Koeficienti i pagës së Asistentes Administrative është 4.5.
  - 1.8. Vlera e Koeficientit të pagave në OFTK është 120 EURO e cila miratohet për ç' do vit buxhetor me raport financiar. Vlera e koeficientit mund të ndryshoj varësisht nga shuma buxheti i OFTK-së
2. Shërbimet e marketingut, IT dhe të Auditimit kontraktohen me kontratë mbi shërbime të veçanta.

**Shtesat**

**Neni 2**

- 2.1. Kryetari i OFTK-se ka te drejtën e shfrytëzimit te derivatit deri ne 150EURO dhe shpenzime te telefonit mobil deri ne 20EURO ne muaj, me kontrate ne emër te ODES.
- 2.2. Sekretari i OFTK-se ka te drejtë të shfrytëzimit dhe shpenzime të telefonit mobil deri në 20EURO në muaj, me kontratë në emër të ODËS.
- 2.1. Zv. Kryetarët e OFTK-se ka te drejtën e shfrytëzimit te derivatit deri ne 100EURO dhe shpenzime te telefonit mobil deri ne 20EURO ne muaj, me kontratë në emër të Odës.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

2.4. Personali i administratës të OFTK-së kane te drejtën e shfrytëzimit prej 10 EURO ne telefon për nevoja te ODËS.

2.5. Anëtarët e Këshillit Drejtues të OFTK-së të cilët jetojnë dhe veprojnë jashtë Prishtinës kanë të drejtën e shfrytëzimit të derivateve për ç'do mbledhje të thirrur nga KD/OFTK sipas kilometrave të realizuar nga vendbanimi i tyre deri në selinë e OFTK-së.

2.5. Ndryshimet eventuale për shtesat dhe shpenzimet shtesë për nevojat e OFTK-së përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues

2.6. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të tjera për nevoja të Odës i miraton Këshilli Drejtues

#### Mëditjet Neni 3

3.1. Mëditja për Prokurorin dhe për Kryetarin e Gjyqit te Nderit – 70 EURO Bruto për mbledhje

3.2. Mëditja për anëtarët e Kuvendit të OFTK-së – 70 EURO Bruto për mbledhje

3.3. Mëditja për zv. Prokurorin dhe anëtarët e Gjyqit te Nderit – 60 EURO bruto për takim

3.4. Mëditja për anëtarët e të Këshillit Drejtues të jetë 70 EURO bruto (për Kryesuesin 80), Bruto për takim.

3.5. Mëditja për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të jetë 60 EURO bruto (për Kryesuesin 70), Bruto për takim.

3.6. Mëditja për anëtarët e Këshillit Etik të jetë 60 EURO bruto (për Kryesuesin 70), Bruto për takim.

3.7. Mëditja për anëtarët e Komisioneve të jetë 40 EURO për takim (për kryesuesin 50 EURO) Bruto.

3.8. Anëtarët e deleguar nga OFTK, pjesëmarrës në komisione për përpilim ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore të ftuar nga institucioni iniciues i ndryshimi/përpilimit paguhen me nga 40 EURO bruto në takim nëse nuk paguhen nga institucioni gjegjes. Këta anëtarë duhet të jenë me vendim të shkruar të Kryetarit dhe për te cilët me parë është bërë kërkesë për ta përfaqësuar OFTK-në atje.

3.9. Pagesa e ligjërueseve të ftuar në aktivitete profesionale të organizuara nga OFTK te përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues.

3.10. Mëditja për anëtarët e komisioneve ad-hoc të OFTK-së për punë dhe detyra specifike të jetë 40 EURO për takim (për kryesuesin 50 EURO) bruto

3.11. Mëditja e bashkëpunëtorëve profesional dhe joprofesional në organizimin e kongreseve, konferencave, seminareve dhe trajnimeve përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Odës.

3.12. Të gjitha pagesat bëhen përmes transferit bankar, më së largu deri më 01 të muajit të ardhshëm.





## Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

### Kosovo Chamber of Physiotherapists

3.13. Nëse një anëtar i Kuvendit të Odes është i ftuar për të marrë pjesë në takimin e një mbledhje paguhet njësoj sikurse anëtarët e atij Komisioni.

3.14. Për mbledhjet të cilat janë mbajtur jashtë rregullore së punës dhe nuk ekziston procesverbal i mbajtjes dhe evidenca e takimit, nuk paguhet mëditje

3.15. Paguesa e ligjërueseve, pagesat e stafit organizativ/administrativ për planin emergjent të EVP-së bëhen sipas vendimit nga Kuvendi i dhjetorit i OFTK-së

3.16. Rregullorja hyn në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi.

#### Neni 4

4.1. Kjo rregullore nuk ka efekt retroaktiv.

4.2. Obligohet përgjegjësi financiar për ekzekutimin e pagesave në përputhje me këtë vendim.

4.3. . Kjo rregullore hyn në fuqi nga muaji Janar i vitit 2024 me nënshkrim nga Kryetari/ja e OFTK-së.

4.4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që janë nga fushëveprimi i kësaj rregullore.

Prishtinë, 22.12.2023.

Kryetari i OFTK-së  
Ass MSc Feim Gashi PT

